



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË FIER

Nr. 3279 / Prot

Fier më, 27 / 03 / 2025

PROCES VERBAL

Mbledhja e Këshillit të Bashkisë datë 27.03.2025. Sot në sallën e mbledhjeve ora 12:00. Të pranishëm në mbledhje 34 këshilltarë.

Znj. Antoneta Çunaj

Përsëritje të gjithëve! Fillojmë mbledhjen e radhës të ditës së sotme të datës 27.03.2025 ora 12:00. Rendi i ditës ju ka ardhur kohë më parë dhe krahas rendit të ditës kanë ardhur për tu futur në rendin e ditës edhe dy projekt vendime dhe dy relacione. I pari është projekt vendimi: Rikonstruksioni i rrugës “Kastriot Muço” segmenti (kryqëzimi me Rr. Mujo Ulqinaku) - Kryqëzimi me unazën “Skëndëerbeu”), (Zgjerimi i rrugës)

Së dyti projekt vendimi “Per miratimin e financimit të projektit: Mur mbajtes ne rrugen rurale ne fshatin Peshtan Bregas, Njesia Administrative Frakull, Bashkia FIER. Kemi dhe dy relacione.

Së pari: “Për dhënien ose jo të pëlqimit në parim për vijimin e procedurave të negocimit për zhvillimin dhe shkëmbimin e pasurive nr. 7/667, 7/498, (7/361) zk 8531, në pronësi të Bashkisë Fier, pasurisë nr. 3/593 zk 8532, pronë shtetërore në administrim të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, sipas projekt propozimit të paraqitur nga DRSHTR Fier.

Relacioni i dytë është informues: “Për vazhdimin e punimeve në fazën e dytë të unazës së Cakranit”.

Pika e parë e rendit të ditës

Miratimi i rendit të ditës.

Znj. Antoneta Çunaj

Fillimisht miratojmë rendin e ditës të miratuar në mbledhjen e kryesisë të datës 17.03.2025. Po.

Z. Ilia Fili

Zonja kryetare, përpara se të kalojmë në këtë votim të miratimit, personalisht gjithë jam interesuar, e kam patur mjaft të vështirë për ti parë këto materiale në telefon, ndërkohë që këtu në këtë sallë nga ana e bashkisë na është premtuar që do ti jepej një zgjidhje problemit të njohjes sonë me materialet që ne ti lexojmë me shumë kujdes dhe me vëmendje, deria atje sa u mendua që ne të

paishim edhe me një tabletë në mënyrë që të mund të lexonim materialet sepse në telefon nuk mund të lexosh një material 40(dyzet) faqe, sepse hyn me sy dhe del pa sy. Kështu që ne mund ta miratojmë si plan pune të sotshme, por një gjë duhet të keni parasysh, që ne shumë nga këto materiale nuk kemi mundur ti shohim.

Znj. Antoneta Çunaj

Nga ana e sekretarisë së këshillit kam marrë dijeni se materiale janë shpërndarë mgjth të flasi sekretari.

Z. Arnando Çupa

Atëhere , duke e dëgjuar me vëmendje Z. Ilia Fili, ai thotë se nuk arrinë dot ti lexojë jo se nuk janë pasqyruar materialet dhe Z. Ilia Fili ka ardhur dhe i ka marrë edhe në mënyrë shkresore materialet. Ajo që përmend Z. Ilia Fili ka të bëjë me tabletët elektronik që është diskutuar edhe më parë.

Znj. Antoneta Çunaj

Në lidhje me tabletët kemi folur edhe në mbledhjet e mëparëshme, dhe bashkia Fier është duke operuar në lidhje me këtë fakt dhe sapo të përfundojë procedura përkatëse, sepse ka një procedurë të tillë për blerjen me prokurim publik të tyre dhe sapo të përfundojë kjo procedurë të gjithë këshilltarët do të paise me tabletët elektronik sepse edhe vetë kryetari i bashkisë e ka diskutuar këtë fakt këtu në këshill.

Z. Endri Jaupaj

Në lidhje me materialet, vetëm për Ilia Filin printohen materialet apo duhet të jenë edhe për kryetarët e grupeve se unë personalisht nuk i kam marrë të printuara.

Znj. Antoneta Çunaj

Z. Endri Jaupaj në lidhje me materialet dua tju them se kemi rënë në dakortësi që do të marri çdo këshilltarë që paraqitet në sekretari për materialet e printuara dhe sekretari është i obliguar që të paisi me materialet e printuara secilin prej këshilltarëve të paraqitur në sekretari dhe kush nuk paraqitet për ti marrë këto materiale në sekretari , materialet janë të nisura në rrugë elektronike. Z. Ilia Fili duke qënë dhe në një moshë relativisht të madhe, por që për ne është i ri, por edhe sepse është korrekt shkon gjithmonë pranë sekretarisë për të tërhequr materialet e printuara. Kush kërkon tjetër të shkojë dhe i ka të printuara pranë sekretarisë së këshillit nga sekretari. Asnjëherë nga ana e sekretarisë së këshillit nuk është bërë pengesë për tju vënë materialet e printuara. Kush ka bërë kërkesë i ka marrë materialet.

Fillojmë me miratimin e rendit të ditës. Kush është dakort?

Pro 34 vota

Kundra nuk ka.

Abstenim nuk ka.

Miratohet

Kush është dakort për të futur në rendin e ditës edhe pikat shtesë që ju lexova më sipërm?

Pro 33 vota

Kundra 1 votë.

Abstenim nuk ka.

Miratohet

Pika e dytë e rendit të ditës

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së këshillit bashkiak të datës 27.02.2025

Znj.Antoneta Çunaj

Vazhdojmë me pikë e dytë të rendit të ditës për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së këshillit bashkiak të datës 27.02.2025 Të flasi në fillim sekretari i këshillit bashkik dhe më pas ta hedhim për votim.

Z.Armando Çupa

Atëherë ashtu si e kemi vendosur edhe në kryesi, me tu hartuar procesverbali dhe me tu redaktuar nga ana ime, direkt u dërgohet kryetarëve të grupeve në e-mail dhe pastaj përfaqësuesit e tyre që dëshirojnë ta firmosin procesverbalin vijjnë dhe e firmosin atë.Pra prprocesverbali u është dërguara me e-mail të gjithë kryetarëve të grupeve. Faleminderit!

Znj.Antoneta Çunaj

E hedhim në votim të nderuar këshilltarë?Kush është pro?

Pro 32 vota

Kundra 1 votë.

Abstenim 1 votë.

Miratohet

Pika e tretë e rendit të ditës

Projekt vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi I kushtëzuar 6% për muajin shkurt 2025”

Znj.Antoneta Çunaj

Fillimisht të flasi përfaqësuesi i bashkisë dhe më pas përfaqësuesi i komisionit dhe pastaj këshilltarët që dëshirojnë të flasin.

Znj.Suela Prifti

Përshëndetje!Sot jemi për të miratuar ndihmën ekonomike nga fondi I kushtëzuar 6% .Gjithsej janë 48(dyzet e tetë) familje që përfitojnë nga ky fond, 3(tre) prej të cilave dalin nga sistemi për arsye se kanë disa muaj që janë nënshtruar kësaj ndihme ekonomike, por duke qënë se do të bëhet një verifikim për ndryshimin e statusit financiar të tyre, për këtë arsye do të dalin dhe ndërkohë janë futur 2(dy) familje të reja.Këto janë gra, kryefamiljare të cilat nga verifikimi nga administrator social është vënë re që gjendja e tyre financiare dhe kushtet ekonomike nuk janë të mira.Gjithashtu ato janë afër pragut të pensionit dhe duke qënë se mundësia e punësimit është pothuajse shumë e ulët, pra e pamundur, është parë e arsyeshme që të futen në këtë skemë. Fondi I miratuar për këto familje është rreth 217 mijë lekë të reja.Nqs keni ndonjë pyetje?

Z.Elvi Daka

Përshëndetje të gjithëve! Përsa I përket komisionit të Mirëqënies Sociale, ku është trajtuar ky projekt vendim, kemi 3(tre) famije ashtu sikurse e përmendi edhe përfaqësuesja e bashkisë që I përkasin Rajonit1, Rajonit 4 dhe NJA Portëz, që dalin nga sistemi për verifikim të gjendjes së tyre sociale ekonomike, dhe në kuadër të raporteve sociale të paraqitura nga administratorët social, kemi 2(dy) familje të reja të cilat I përkasin Rajonit 1, 1(një) familje dhe nga Rajoni 2, 1(një) familje, kryefamiljare të cilat, hyjnë në skemën e ndihmës ekonomike. Për ne si komisioni vazhdon që të jetë disi problem pagesa e ulët e ndihmës ekonomike me të cilën këto familje trajtohen, por është një kompetencë që është jashtë institucionit të bashkisë, është e përqëndruar në të gjithë vendimet që merren nga qeveria.Ndaj nqs ne kemi mundësi që të bëjmë diçka, për ta parë me prioritet këtë gjë do të ishte mirë.Pjesa tjetër e dokumentacionit ishte në rregull, raporti social I kishte të gjitha pikat e nevojshme për tu futur brenda sistemit. Faleminderit!

Znj.Antoneta Çunaj

Komisioni ka marrë vendimmarrje?

Z.Elvi Daka

Po.Të katër anëtarët e komisionit që kanë qënë të pranishëm kanë votuar pro.

Z.Arben Çuko

Do të shtoja diçka me këtë fondin që marrin këta persona, që trajtohen me ndihmë sociale, të cilët janë persona në nevojë, doju tju thoja që , ne si opozitë do ta ngremë dorën pro atyre, por do tju thoja që në lidhje me këto politikat që ndjek bashkia dhe qeveria, të heqin ata patronazhistët që rrinë tre katër veta , si familje në vendet e punës dhe të vendosin ndonjë nga këto kryefamiljaret hallexhinj, se me këtë përkrahjen sociale çfarë mund të bëjë jë kryefamiljarë.Kaq kisha, falemiinderit!

Znj.Antoneta Çunaj

Pyetje, diskutime rreth këtij project vendimi ka? Po inxhinier.

Z.Ilia Fili

Jam kurioz të dijë, këto janë, mqs bëhet fjalë për zonja, janë në moshë pensioni apo nënë moshë pensioni?

Znj.Suela Prifti

Janë nën moshë pensioni.

Z.Ilia Fili

Përpara nja 5-6 ditësh, u reklamua një panair i madh I punës në Fier, ku rezultoi se ishin 1800 vende bosh. Çfarë dmth kjo? Këtej ne ndihmojmë njerëz që natyrisht duhen ndihmuar, në parim, këtej deklarojmë që kemi 1800 vende pune bosh.Çfarë bëhet? Një kontraditë shumë e ndjeshme dhe e kapshme menjëherë.O këto vende pune nuk janë funksionale ose këto persona nuk janë në gjendje fizike të punojnë.

Znj.Antoneta Çunaj

Nuk është vetëm gjendja fizike por mund të jetë edhe niveli arsimor të cilin e kërkojnë këto 1800 vende pune dhe çfarë moshe, se ka disa kritere.Këto vende pune mund të kenë kriter moshën, profesionin dhe arsimin përkatës. Mgjith përfaqësuesja e bashkisë të japi një mendim për pretendimin e ngritur nga këshilltari.

Znj.Suela Prifti

Ju kryetre pak a shumë e sqaruat por unë kam patur fatin të jem edhe disa muaj dretoreshe e Zyrës së Punës dhe pak a shumë I njoh problematikat atje dhe të them të drejtën pjesa më e madhe e këtyre vendeve të punës që ofrohen janë biznese private të cilët kanë kritere, dhe një ndër kriteret që ata kanë është edhe mosha.Dhe jo pa arsye e përmenda pak më lartë që personat e sipërpërmendur janë afër moshës së pensionit dhe nuk përfitojnë dot as nga skemat e sigurimeve shoqërore që të marrin një farë pensioni.Kështu që kjo është arsyeja.

Znj.Antoneta Çunaj

A ka ndonjë pyetje tjetër? Mqs nuk ka e hedhim në votim.Kush është pro?

Pro 34 vota

Kundra nuk ka.

Abstenim nuk ka.

Miratohet

Pika e katërt e rendit të ditës

Projekt vendim “Për Miratimin e Raportit për Vlerësimin dhe Parashikimin Afatmesëm të të Ardhurave të vitit 2026-2028”

Znj.Antoneta Çunaj

Fillimisht të flasi përfaqësuesi i bashkisë.

Znj.Eleni Gjikondi

Përshëndetje të gjithëve! Kemi paraqitur përpara jush projekt vendimin për mënyrën e vlerësimit dhe parashikimin Afatmesëm të të Ardhurave të vitit 2026-2028” Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme janë pragu mbi të cilën do të hartohen tavanet 2026-2028. Raporti i vlerësimit përmban: dy vitet e para të vitit buxhetor faktin e dy viteve të para, vitin buxhetor të pritshmin dhe tre vitet e ardhshëm 2026-2028. Kemi përcaktuar metodologjinë e përdorur për hartimin e këtij projekt vlerësimi, politikat që kemi marrë tatimore për hartimin dhe mbledhjen e të ardhurave. Cilat janë burimet e të ardhurave dhe parashikimet afatmesëm? Këto janë të ardhura të ardhura nga burimet lokale dhe burimet qendrore, Burimet lokale janë taksat vendore, burimet qendrore janë të ardhurat nga transfertat sektoriale, plani I pakushtëzuar dhe nga të ardhurat e trashëguara.Kemi marrë numrin e taksapaguesve në qytetin e Fierit, për tatimpaguesit familjarë, bizneset sipas natyrës së veprimtarisë së tyre. Atëherë fillojmë me taksën e parë.Të ardhurat nga taksat e kalimit të pronësisë. Kjo taksë administrohet nga ASHK-ja ku ajo vepron si agjent tatimor dhe 97% e taksës së mbledhur ja kalon bashkisë Fier.Kështu e kemi lënë edhe tendecën e të ardhurës në tre vite, por duke parë se të ardhurat nga kjo kanë qënë më të ulëta sesa ato të parashikuara në vitin 2026-2027, kemi lënë mesataren e përgjithëshme të tre viteve, në fakt, dhe kemi vendosur vlerën 14813 mijë lekë. Vlerat janë në mijë lekë.Të ardhurat nga taksa e tokës bujqësore. Sipërfaqja e tokës bujqësore në bashkinë e Fierit është 192 578 196 m2. Kemi vendosur çmimin e saj dhe kemi akorduar 25% dhe jo 100% të vlerës në bazë të VKM-së. Të ardhurat nga toka bujqësore që do të mblidhen në vitin 2028 janë 71 milion e 311 mijë lekë. Të ardhurat nga taksa e regjistrimit të automjeteve, kjo taksë mblidhet nga DRTRRSH, 18% të saj I kalohet bashkisë së Fierit edhe kjo nga ecuria e të ardhura të tre viteve të fundit është përcaktuar vlera. Taksa e tabelës e cila bëhet për tre qëllime identifikimi, tabelat e reklamimit për qëllime ekspozimi. Vlera e kësaj takse është në vlerën 8 milion e 995 mijë lekë. Taksa e zënies së tregut është për bilrtat e tregut të lëvizshëm dhe është bërë për vitin e fundit, me faktin e vitit 2024 në vlerën 19 milion e 479 mijë lekë. Taksa e ndërtesës.Kjo taksë është për të gjithë familjarët që posedojnë një ndërtesë dhe mblidhet nga ujësjellësi, si agjent tatimor dhe është me çmimin 21.24 lekë për NjA dhe 26.55 lekë për rajonin dhe për qytetin.Taksa e ndikimit në infrastrukturë është nga ndërtimet e reja.duke qënë se në tre vitet e fundit kjo taksë ka qënë e ulët kështu që edhe për vitin 2028 është përcaktuar me vlerën mesatare të tre viteve të fundit. Taksa e fjetjes në hotel është bërë një përlllogaritje se sa net fjetje dhe se sa është numri I personave që flenë nëpër hotele dhe është vendosur vlera e llogaritjes. Taksa e truallit. Kjo taksë administrohet nga bashkia Fier dhe është për të gjitha trohet që kanë administrim bashkia Fier.Është vendosur në vlerën 15 duke qënë me faktin e vitit të fundit. Taksa e tatimit mbi të ardhurat personale.Është vendosur me trendin që ka në vitin e fundit.Duke qënë se në 6 muajt e fundit kjo vlerë ishte rritur u përpjestua

me 6 muaj dhe u shumëzua me 12 muaj dhe është vendosur vlera 688712 mijë lekë. Të ardhurat nga tarifat vendore. Tarifat vendore përbëjnë 50.3% të totalit të të tërë të ardhurave të viteve 2026-2028. Tarifat janë. Tarifa e menaxhimit të mbetjeve, tarifa e shërbimit, tarifa e transportit, tarifa e parkimit, tarifat nga dhënia me qera e aseteve të bashkisë, tarifat nga të ardhurat nga kopshtet dhe çerdhet, tarifat nga gjrobat që vijnë nga IMVT-ja dhe MZZH-ja, renta minerare që është një taksë e lartë, të ardhura nga shërbimet e varrimit dhe tarifa të tjera që mund të jenë shërbime publike që ofron bashkia Fier. Të ardhurat nga transfertat specifike, këtë vit, me udhëzim buxheti ka ardhur që të jetë e njëjtë me faktin e vitit 2021-2025. Dhe kemi vendosur këtu buxhetin për të gjithë transfertën sektoriale dhe kemi vendosur dhe parashikimin e transfertës së pakushtëzuar dhe të ardhurat që sapo thamë në vite. Faleminderit! Në rast se keni ndonjë pyetje?

Znj. Antoneta Çunaj

Kush e do fjalën nga anëtarët e këshillit?

Z. Endri Jaupaj

Jam i bindur që e kuptuan të gjithë. Komisioni përkatës është mbledhur për këtë projektvendim?

Znj. Erlinda Llupi

Po komisioni u mbledh në datën 24.03.2025 dhe vendosi tja kalojë këshillit për miratim këtë projektvendim.

Znj. Antoneta Çunaj

A ka diskutime të tjera për pikën katër të rendit të ditës? Nëse jo e hedhim në votim.

Z. Ilia Fili

Ne para disa kohësh, kaluam këtu në këshill, një program deri në 2027, në mos gaboj. Sot shtohet dhe një vit dhe shkohet në vitin 2028. Kur diskutuam atë program unë bëra disa sygjerrime dhe disa vërejtje, lidhur me metodikën e planifikimit prognoz. Për planifikimin prognozë, ka disa rregulla strikte, që ekonomistët I dinë më mirë se unë. Pra duhet të kesh parasysh çfarë të ardhure kam unë sot, dhe çfarë do të shtohet nesër, qoftë në të ardhurat, qoftë në shpenzimet, që unë të bëjë planifikimin në prognozë në vite. Me sa shoh, në këtë material është një ripërsëritje, copy paste, i programit 2025-2027 ku shtohet viti 2028. Por çfarë konstatojë, që gjithë u sygjerojmë shumë miqësisht, shumë shoqërisht, por edhe teknikisht që prognoza në vite të bëhet me një metodikë të caktuar. Të gjithë ne këtu e dimë shumë mirë që çdo qeveri që mund të vijë ka në programin e saj, rritjen e pagave. Çdo qeveri të vijë kanë detyrim ligjor që të indeksojë pagat me inflacionin, kjo do të thotë që nqs një punonjës këtë vit e ka rrogën 30 lekë, nesër do ta ketë 31 sepse do ti shtohet indeksimi por mund të ketë rritje edhe për efekt të pagës. Kjo sjell që njëri vit dhe viti pasardhës do të jetë më i vogël se pasardhësi, gjithmonë në vijim. Po të shikoni tabelën, janë fikse, kjo është e para, dhe e dyta. Konstatojë që kur vjen puna tek shpenzimet operative apo tek ato kapitale shikon që në përgjithësi.

Znj. Eleni Gjikonaj

Jemi tek vlerësi dhe jo tek tavanet, pra jemi tek pika katër dhe jo tek pika pesë.

Z.Ilia Fili

Qartë, po marr më të thjeshtë. Shpenzimet koherente të tjera janë në vitin 2026 janë 186 dhe në 2027 zbresin në 156 dhe në vitin 2028 ngrihen në 196

Znj.Antoneta Çunaj

Më fal inxhinier por jemi në pikën katër të rendit të ditës, dhe ju po diskutoni për pikën pesë të rendit të ditës.

Z.Ilia Fili

Më falni, se kujtova se ishim tek pika pesë e rendit të ditës.

Znj.Antoneta Çunaj

Ka të tjerë për të diskutuar për pikën katër të rendit të ditës? Nuk ka, atëherë kalojmë në votim. Kush është pro?

Pro 33 vota

Kundra 1 votë .

Abstenim nuk ka.

Miratohet

Pika e pestë e rendit të ditës

Projekt vendim “Për Miratimin e Tavanëve Përgatitore të Shpenzimeve të Buxhetit Afatmesëm 2026-2028 të Bashkisë Fier”

Znj.Antoneta Çunaj

Mqs ishit duke diskutuar inxhinier për këtë projekt vendim, vazhdoni fjalën.

Z.Ilia Fili

Pra unë kam sygjerruar pikërisht që metodologjikisht të zgjidhet drejtë vlera për vitet në prognozë. Veç kësaj shoh këtë luhajtjen në vlera nga një vit në tjetrin, ngrihet , ulet, ngrihet psh kam shumë që kam verifikuar në këtë material po marrë një rast që bie në sy shumë, taksë tabele.Thotë në vitin 2022 është 2800, në vitin 2023 është 3400, në 2024 është 8900, në 2025 është 2900-3000 pra është një rënie trefish, dhe kjo vlerë qëndron deri në vitin 2027 dhe në vitin 2028, çuditërisht zbret në 9000.Një mekanizëm I cili më duket I pakuptueshëm, Dhe sido që ta shpjegojë përfaqësuesja e bashkisë unë prapë nuk e kuptojë dot këtë lloj mekanizmi, dhe një gjë të tillë e shoh në shumë zëra dhe jo vetëm në këtë zë. Kjo është vërejtja ime që kam bërë dhe vazhdojë ta bëjë përsëri për këtë prognozë, dhe fatkeqësisht kur miratuar ne prognozën deri në vitin 2027, sygjerrime që unë i bëj si një

individ i thjeshtë, ndërkohë që grupi matanë hesht kompletë, ka të drejtë se kërkon të miratohet dhe përpiluesit i referohen miratimit. Por pikërisht këtu kërkohet përgjegjësia, që secili nga ne të japi mendimin e tij. Ndërsa kalimi pastaj me një votë të thjeshtë me një ngritje kartoni humbet pastajë vlerën e saj. Faleminderit!

Znj.Antoneta Çunaj

I lutem përfaqësueses së bashkisë ta sqarojë këshilltarin në lidhje me shqetësimin që ai paraqiti.

Znj.Eleni Gjikonaj

Atëherë kjo pyetja e dytë ishte për vlerësimin e të ardhurave. Atëherë për vlerësimin e të ardhurave, për zërin taksë tabele, 2 milion e 839 mijë është fakti i 2022, 3 milion e 472 mijë është fakti i 2023, 8 milion e 906 mijë është fakti i 2024, I pritëshmi i 2025 ka qënë i miratuar më përpara në vendimin e këshillit për 2025-2027 dhe nuk ka ndryshuar pasi ne kemi paraqitur buxhetin për këto dy vite 2025-2027 dhe jemi hedhur në vitin 2028 duke u bazuar në faktin e vitit 2024 duke qënë se kemi patur rritje 2028 e kemi bërë 8 milion e 995 mijë lekë, dmth ne kemi vlerësuar vetëm vitin 2028 se 2025-2027 ne e kemi patur të miratuar me vendim këshilli. Përsa i përket shpenzimeve, pasi kjo e para ishte për vlerësimin e të ardhurave, tavanëve, ne marrim parasysh të ardhurat që kemi në këtë vitzërin buxhetor dhe udhëzimi i ministrisë kështu ka ardhur. Për transfertat specifike sektoriale ka ardhur buxheti për 2025. Dhe pagat ne kemi duke u bazuar në VKM-në që kemi pagën aktuale sot. Për planin e shpenzimeve bazohemi në vitin që kemi aktual, në planin që është bërë aktual dhe prandaj nuk ndryshojmë dotë as planin e shpenzimeve në vite. Kemi ndonjë ulje pasi nuk kemi transfertën e trashëguar prandaj kemi në vitin 2026 ose 2027 më të ulët vlerën se sa viti 2025 sepse nuk kemi paraqitur transfertën e trashëguar, pasi nuk e dimë sot sesa do të trashëgojmë ne në vitin 2028, mund të mos trashëgojmë asnjë fond, mund ti harxhojmë gjatë vitit, prandaj nuk e parashikojmë dot në këtë stad që jemi. Kur të hartojmë buxhetin atëhere ne shikojmë dhe bëjë vlerësimin dhe sa na ngelet, prandaj shtohet buxheti në vite. Edhe për 2025 fakti është shumë i lartë për shkak të të trashëguarës që neve miratuam në shkurt. Faleminderit!

Znj.Antoneta Çunaj

Diskutime rreth këtij projekt vendimi ka të tjerë këshilltarë? Ta hedhim në votim. Kush është pro me pikën pesë të rendit të ditës?

Pro 32 vota

Kundra 2 vota .

Abstenim nuk ka.

Miratohet

Pika e gjashtë e rendit të ditës

Projekt vendim“ Për shpërndarjen e tre banesave sociale me qera të cilat rezultojnë të lira nga menaxhimi i banesave sociale me qera pranë bllokut të banesave sociale, lagjia 16 Prilli Fier për tre familje të pastreha”

Znj.Antoneta Çunaj

Fillimisht të flasi përfaqësuesja e bashkisë.

Znj.Esmeralda Kapllanaj

Bazuar në materialin për të cilin është paraqitur projekt vendimi dhe relacioni përkatës, vjen duke i referuar kërkesës që bëhet nga Zyra e Menaxhimit dhe Administrimit të banesave sociale me qera për tre apartamentet që rezultojnë bosh si rrjedhojë e verifikimit të kushteve sociale dhe ekonomike të atyre familjeve që kanë qënë atje. Nga ana e drejtorisë ekzekutive janë administruar këskesat e familjeve që kanë aplikuar për këtë program strehimi. Pasi është verifikuar dokumentacioni në përputhje me kërkesat ligjore janë ezauruar edhe mbledhjet e komisionit të strehimit duke i shqyrtuar në përputhje me kriteret ligjore dhe sistemin e pikëzimit të miratuar. Referuar materialit komisioni i strehimit me votat pro, të të gjithë anëtarëve të komisionit kanë rezultuar për tre familjet përfituese të paraqitura edhe në projekt vendimin përkatës. Shpërndarja e apartamenteve sipas strukturave përkatëse është bërë referuar përbërjes së tyre familjare. Dy struktura garsionere i janë shpërndarë dy familjeve që rezultojnë me një anëtarë dhe një apartament me strukturë 1+1 i është dhënë një familje me tre anëtarë në përbërje familjare. Familjet rezultojnë me statusin, dy prej tyre me kryefamiljarë të divorcuar kurse një familje ka një anëtar. Menaxhimi i banesave sociale me qera, është një menaxhim që vjen kohë pas kohe dhe gjithmonë kur apartamentet janë bosh, pasi vërkohen kërkesat e familjeve për këto banesa dhe ezaurohen procedurat dhe mbledhjet e komisionit të strehimit, i propozohen këshillit të bashkisë Fier për ti shpërndarë për shtresat në nevojë.

Znj.Antoneta Çunaj

Po, faleminderit! Komisioni përkatës është mbledhur për këtë projekt vendim?

Z.Endri Jaupaj

Komisioni është mbledhur dhe është një nga komisionet më funksionale, dhe i ka të gjitha materialet vetëm unë do të kisha një kërkesë të vogël që të ngrihej një grup pune për ato banesa që të kontrolloheshin një për një të gjitha apartamentet që do të ishin në konflikt me ligjin.

Znj.Antoneta Çunaj

Ato që janë dhënë?

Z.Endri Jaupaj

Po për ato që janë dhënë. E kam kërkuar këtë por nuk kam marrë asnjë përgjigje nga ekzekutivi.

Znj.Evis Sema

Cili është kuptimi në konflikt me ligjin?

/

/

Z.Endri Jaupaj

Në konflikt me ligjin njerëz që nuk duhet të rrinë më në ato apartamente sepse kanë të ardhura të mjaftueshme për të marrë një apartament tjetër e kështu me radhë, janë punonjës të administratës etje etje mqs më pyete.

Znj.Evis Sema

Është e bazuar në fakte kjo apo është një gjë e hedhur kështu me hamendësim.

Z.Endri Jaupaj

Bazuar në fakte, në njerëz që mburren që kanë nga 2-3 apartamente aty.

Znj.Esmeralda Kapllanaj

Mundem të bëjë një sqarim të vogël? Atëherë, banesat sociale me qera që janë pranë bllokut të lagjes 16 Prilli, gjithësej 96 apartamente, janë miratuar me vendim këshilli dhe gjithë kohën janë bërë verifikime në lidhje me ato familje që banojnë atje dhe kushtet ekonomike financiare. Ka dhe një grup pune, dhe është bërë edhe një informacion që radhës tjetër edhe mund t'jua serviri Zyra e Menaxhimit dhe Administrimit të banesave sociale me qera. Prandaj dhe para dy mbledhjeve të mëparshme po nga ky këshill janë shpërndarë 5(pesë) apartamente .Po në këtë mbledhje ju propozohet shpërndarja e 3(tre) apartamenteve bosh. Kjo tregon që ato banesa atje menaxhohen dhe administrohen në varësi të kushteve social ekonomike të atyre familjeve.

Z.Endri Jaupaj

Kërkesa ime ka qënë thjeshtë tek transparenca, që të kishim edhe përfaqësues të këshilit bashkiak.

Znj.Esmeralda Kapllanaj

Fakti që atje familje largohen dhe futen familje të reja tregon që menaxhimi dhe administrimi i tyre bëhet në përputhje me ligjin.Mgjith informacionin e detajuar nëse e dëshironi jua sjellim.

Znj.Antoneta Çunaj

Mgjith nëse ju i nderuar këshilltarë keni ndonjë problematikë në lidhje me këtë fakt ose keni ndonjë informacion përcillja drejtorisë përkatëse.

Z.Endri Jaupaj

Unë nuk marrë përsipër të marrë rolin e prokurorit, unë fjalën kamë në këtë karrike këtu dhe fjalën time do ta përdorë, sepse qëllimi jonë këtu është që të ndihmojmë ata që janë vërtetë në nevojë, sidomos tek këto pika që janë sensitive.

Znj.Antoneta Çunaj

Keni pretendime të tjera? Nëse jo ta hedhim në votim.Kush është pro?

Pro 34 vota

Kundra nuk ka.

Abstenim nuk ka.

Miratohet

Pika e shtatë e rendit të ditës

Projekt vendim “Për trajtimin me ndihmë financiare të familjes së shtetasit Selim Stafa, fshati Baltëz, NjA Ndërmënas, për dëmet e shkaktuara në banesën e tij nga zjarri i datës 10.03.2025”
Znj.Antoneta Çunaj

Ky material ju ka ardhur.Ka ndonjë këshilltarë që do të diskutoj rreth këtij materiali?

Z.Endri Jaupaj

Unë e kam lexuar materialin dhe është një nga materialet më të mira që më ka rënë në dorë dhe marr shkak këtu që të ndjekin metodologjinë që ka përdorur zotëria tek përgjegjësia dhe referuar ligjit, VKM-ve .Ka bërë një punë shumë të mirë dhe vota ime është pro.

Znj.Antoneta Çunaj

Komisioni është mbledhur në lidhje me këtë projekt vendim?

Z.Endri Jaupaj

Po komisioni është mbledhur, po ta them si anëtarë i komisionit unë këtë.Kur materiali është i plotë , është i plotë.

Znj.Antoneta Çunaj

Dakort! E hedhim në votim pikën shtatë të rendit të ditës. Kush është pro?

Pro 34 vota

Kundra nuk ka.

Abstenim nuk ka.

Miratohet

Pika e tetë e rendit të ditës

Projekt vendim “Për pagesën e shpenzimeve të varrimit të zonjës Bukurie Metua”

Znj.Antoneta Çunaj

E hedhim në votim.Kush është pro?

Pro 34 vota

Kundra nuk ka.

Abstenim nuk ka.

Miratohet

Pika e nëntë e rendit të ditës

Projekt vendim” Për miratimin e planit vendor të veprimit për emigracionin dhe diasporën për vitin 2025-2030 për Bashkinë Fier”

Znj.Antoneta Çunaj

Fillimisht të flasi përfaqësuesja e bashkisë për këtë projekt vendim.

Znj.Suela Prifti

Ky është një plan i cili financohet nga qeveria Gjermane,dhe është vënë në zbatim nga projekti GIZ.Ky plan ka si qëllim të përmirësojë kushtet e qytetarëve tanë që kanë vendosur të rikthehen këtu . Dhe vetë bashkia e Fierit jep angazhimin e saj maksimal për të rritur mirëqënien e këtij komuniteti dhe duke fortësuar dhe lidhjet me qytetarët që jetojnë dhe punojnë jashtështetit por që akoma janë të lidhur shpirtërisht me qytetin tonë ku ne jetojmë, pra me qytetin e Fierit.Të gjithë ne jemi prekur nga fenomeni i emigracionit, dhe besoj që nuk ka ndonjë prej nesh që nuk ka ndonjë të afërt në emigracion.dhe qëllimi i këtij projekti ky është, që të riabilitohen personat të cilët janë kthyer me vullnetin e tyre të lirë dhe me dëshirën e tyre në vendlindje dhe duan që të gjejnë vetveten po këtu.Ky është vetëm thjesht një projekt, një program.Gjthashtu nëpërmjet mekanizmave dhe strukturave të posatshme mbështet diasporën dhe emigrantët që jetojnë andej. Nëpërmjet këtij programi, do të ngrihen struktura të posatshme administrative, pasi sot për sot ne kemi vetëm një punonjëse ndërkohë që në kohët në vijim, pasi të bëhet miratimi i saj, do të ngrihet një strukturë e posatshme që do të merret me këtë projekt ose këtë program që të lehtësojmë sa më shumë personat që jetojnë jashtë dhe duan që të rikthehen këtu, për të gjetur veten e tyre në vendin e vetë.

Z.Endri Jaupaj

Kemi statistika të atyre që dëshirojnë të rikthehen, kemi numra pak a shumë ?Roli i bashkisë, të cilin unë e kam thënë shpesh, duhet të jetë që të paktën ne nuk mund ti ndalojmë të gjithë sepse ne Gjermani nuk e bëjmë dot me një ditë, por të paktën të kemi politika që të frenojmë ikjen masive sepse e kam thënë shpesh këtu që qyteti jonë po venitet.Mosha e tretë po dominon në çdo cep të qytetit.Dhe do të ishte shumë mirë që ky program të funksiononte, ndihmën tonë do ta keni gjithmonë patjetër.

Z.Elvi Daka

Në fakt unë kam disa edhe sygjerime por pikëpyetje që lindin rrjedhimisht duke lexuar këtë planin e veprimit të emigracionit .Në fakt plani i veprimit për emigracionin është një prej atyre strategjive apo manualeve që duhet ta ketë çdo bashki për të thithur projekte dhe programe të ndryshme nga donatorë të ndryshëm. Por ajo që ky plan duhet të ketë në brendësinë e tij është strukturat që duhet të ngrihen të reja nga institucioni i bashkisë apo nga institucione të ndryshme për të ofruar shërbime të shumëllojshme për këtë kategori njerëzish. A kemi parashikuar ne si bashki e Fierit ndonjë program specifik apo ndonjë strukturë të posatshme që do të merret me këtë pjesë?

Znj.Suela Prifti

Nqs do të bëhet miratimi i saj, pasi tani është thjeshtë një projekt, patjetër që do të ketë, madje është pika e parë që është përmendur aty, që do të ngrihet një grup specialistësh që do të merren pikërisht me këtë punë.

Z.Elvi Daka

Ok! Ndërsa sygjjerimi i dytë është fakti që shumica e emigrantëve të kthyer është jo vetëm ata që jetojnë me dokumentacion të rregullt jashtë por edhe ata që shkojnë për të kërkuar azil pra që vijnë nga shtresat e ndryshëm vulnerabël, që jetojnë dhe bashkëjetojnë me ne në qytetin e Fierit, duhet të jetë një urë lidhëse midis ofrimit të shërbimeve dhe atyre që ta marrin shërimin sepse është një hendek i madh i mungesës së informacionit. Prandaj do ti sygjjeroja edhe institucionit të bashkisë që të mendonte për këto dy lidhje të rëndësishme.

Znj.Suela Prifti

Ky është pikërisht synimi i këtij projekti që të bëhet urë lidhëse, midis emigrantëve me mungesë informacioni pasi vijnë nga jashtë dhe vendlindjes së tyre.

Znj.Brunilda Hoxha

Edhe unë kryetare kam diçka, në lidhje me kthin e emigrantëve në vendin tonë. Si mund të krijohet lidhja e tyre me organet drejtuese këtu që të mund të japin ndihma të posatshme për ta dhe janë ndihma për të gjetur punë, për të hapur një biznes etje.Cilat janë rrugët që mendoni për të ndihmuar këta njerëz.

Znj.Suela Prifti

Ashtu sikurse e thashë edhe më lartë, nëse do të miratohet ky projekt, do të ngrihen strukturat apostafate nga ana e administratës të cilat do të merren për këtë gjë psh një emigrant që ka ardhur nga emigrimi dhe kërkon të orjentohej këtu për gjetjen e një pune, mbase ky kërkon punë në shtet , por punë në shtet nuk ka për të gjithë, do të adresohet tek zyra e punës, ku mund të ketë vende vakante të lira, pastaj është problemi i tyre nëse bien ose jo dakort me bizneset për pagesën, por të paktën ata orjentohej.

Z.Elvi Daka

Lidhur me këtë gjë , bashkia e Fierit ka nevojë të ngrejë një njësi për vlerësimin dhe referimin e nevojave dmth edhe në bazë të ligjit në fuqi ne duhet të kemi një njësi të tillë që të marrin të gjitha nevojat dhe problematikat e tyre.

Znj.Brunilda Hoxha

Të bëhet çështje e mundur që të lehtësohen gjërat sepse unë jam një nga emigrantet e që jam kther dhe nuk është aspak e lehtë që këtu të gjesh vehten, pa patur pika referimi se ku duhet të drejtohesh.Prandaj them që ti vijmë në ndihmë të rinjëve që vijnë dhe atyre që kanë dëshirë të japin kontribut në vendin e tyre, do të jetë një gjë shumë e madhe.

Z.Arben Çuko

Unë doja të shtoja, do të ishte gjithë e mirë ai plani i veprimit, por le ta lëmë këtë propagandë, se është i pa arritëshme rikthimi i njerëzve, dhe mos i merrni më njerëzit në qafë duke propaganduar rikthimin e tyre. E kuptoni ju se ku jeni? Të rikthehen emigrantët këtu e ku do ta gjejnë veten e tyre këtu? Mund të më thoni se çfarë do tju ofroni ju emigrantëve? Ja ndodhi dhe ajo që erdhën duke bërë sera pasi i ftoi kryeministri që të mos merreshin me ndërtim pallatesh apo me blerje apartamentesh por të ndërtonin sera. Tani nuk ka as punëtorë për ti vjelë serat, i kemi parë problematikat. Unë nuk kam parë nga anëtarët e këshillit bashkiak këtu që të ngrenë këtu lidhur me hallet që kanë këtu. Shikoni këta që janë këtu, që ti krijojmë kushte këtyre këtu, që janë të vetëpunësuar. Në fshatin Petovë, tek Grëmallarët, aty kalon uji dhe ata nuk kanë ujë të pijshëm të marrin, nuk kanë një stabilizatorë tensioni por kanë djekur nga 5(pesë) pompa në biznesin e tyre. Ofroini një stabilizator që ti krijoni kushte bizneseve të tyre, ndërsa ju thoni që të vijnë nga jashtë, jarroini që të vijnë ata nga jashtë. Shikoni rrugët që janë për të bërë që tja lehtësoni atyre punën. Do të shtoja për të gjithë ju, e kam me Evisën që është kryetare e Qarkut, nuk e kam dëgjuar njëherë të ngrejë shqetësimin e ndonjë votuesi të majtë pasi e quajnë bastion të majtësh qarkun e Fierit.

Znj.Evis Sema

Je duke bërë politikë, nuk po diskuton në lidhje me rendin e ditës.

Z.Arben Çuko

Edhe politikë do të bëjmë.

Znj.Antoneta Çunaj

Jemi duke diskutuar për pikën nëntë të rendit të ditës dhe nuk jemi tek pika e diskutimeve.

Znj.Evis Sema

Këtu unë jam Evis Sema anëtare e këshillit bashkiak nuk jam si kryetare e këshillit të qarkut.

Z.Arben Çuko

Më fal 1 minutë. Në të gjithë zonën bregdetare, një shi i vogël bie dhe ikën energjia elektrike dhe ju nuk shqetësoheni fare.

Znj.Antoneta Çunaj

I nderuar këshilltarë, kjo nuk ka të bëjë me pikën nëntë të rendit të ditës, për këtë qëllim ta ndërpres fjalën. A ka ndonjë diskutim tjetër në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës?

Z.Melsi Bogdani

Kam unë diçka të vogël. Tani ky është një plan vendor, pra do të thotë plan vendor i veprimit. Askush për ti thënë kolegut, askush nuk i detyron emigrantët që të kthehen. Ka një plan bashkiak dhe mbi këtë plan e vlerësojnë vetë emigrantët, nuk na takon ne këtu që të themi do të vijnë apo nuk do të vijnë emigrantët, do të kthehen apo nuk do të kthehen emigrantët. Mori një shembull kolegu, serat. Kush e ka marrë përsipër atë investim i përgjigjet vetë atij investimi, ne po bëjmë planin që na takon si bashki.

Z.Arben Çuko

Po zotëri, por ofroi kushte biznesit të tyre.

Z.Melsi Bogdani

Po prandaj bëjmë këtë plan vendor. Qoftë njerëzit e mi apo njerëzit e çdo kujt këtu që duan të kthehen të kenë mundësi që të orjentohen.

Z.Arben Çuko

Lëreni mos u bëni dhe ju demagog si kryeministri juaj. Ju keni këttu njerëz që po vdesin për bukën e gojës, dhe po kërkonin që të kthehen emigrantët këtu. Ku do ti punësoni emigrantët këtu?

Znj.Antoneta Çunaj

Ju thashë Zoti Çuko se diskutimi juaj nuk ka të bëjë me rendin e ditës, gjithë mund tju them në vazhdim të diskutimit tuaj se kanë ardhur edhe këtu në qytetin e Fierit shumë emigrantë, pra janë rikthyer dhe janë shumë të sukseshëm, si me rastet e serave apo dhe me shumë biznese të tjera. Kanë marrë eksperiencë nga vendet ku kanë emigruar dhe kemi shumë biznese të cilët pasi e kanë vënë në zbatim këtë eksperiencë të marrë nga jashtë kanë rezultuar shumë të sukseshëm këtu. Patjetër që ka edhe anomali dhe problematikë edhe në shqipëri sikurse në çdo vend tjetër të europës, por kjo nuk do të thotë shumica e atyre që kanë ardhur nuk kanë qënë të sukseshëm. Një rast kemi anëtarin tonë të këshillit Brunilda Hoxha e cila u rikthye pas shumë viteve emigrimi në Amerikë dhe është integruar më së miri në vendlindjen e saj.

Z.Arben Çuko

Bruna mezi pret që të iki në Amerikë përsëri dhe këtë ja lexojë në sytë e saj.

Znj.Antoneta Çunaj

Nga e di ti, ke diskutuar me të? Ta mbyllim diskutimin këtu dhe ta hedhim në votim pikën nëntë të rendit të ditës. Kush është pro?

Pro 32 vota .

Kundra 1 votë.

Abstenim 1 votë.

Miratohet

Pika e parë shitesë e rendit të ditës

Projekt vendim” Rikonstruksioni i rrugës “Kastriot Muço” segmenti (kryqëzimi me Rr.Mujo Ulqinaku”-Kryqëzimi me unazën “Skënderbeu”), (Zgjerimi i rrugës)

Znj.Antoneta Çunaj

Keni diskutime në lidhje me këtë fakt?

/

/

Z.Endri Jaupaj

I vetmi diskutim është që këto janë mirë që të bëhen pas fushatës, sepse keni patur kohë mjaftueshëm për ti realizuar këto projekte dhe I keni lënë një javë apo një muaj përpara fushatës dhe kjo nuk është një gjë e mirë. Nuk ju çon askund kjo gjë. Nuk mund të bëhet qyteti kantier ndërtimi një muaj përpara zgjedhjeve. Nuk të voton më njëri kështu.

Znj. Antoneta Çunaj

Për sa i përket fushatës, kjo rrugë ka mbaruar. Ne e kemi miratuar shumë kohë më përpara dhe është inaguruar si rrugë. Nuk është një rrugë që po bëhet rishtas. Tani kërkohet një zgjerim i saj, kjo do të thotë tjetër gjë. Për shkak të pozicionit dhe që ajo të bëhet më e aksesueshme si për mjetet dhe për qytetarët është kërkuar zgjerimi i një pjese të saj, pra nuk është rrugë e re.

Z. Ilia Fili

Kryetare një sqarim ju lutem. Bëhet fjalë për segmentin nga hekurudha deri tek kryqëzimi i Greçallisë? Për cilën pjesë bëhet fjalë?

Z. Agron Profka

Bëhet fjalë për rrugën nga hotel "Leone" deri tek kryqëzimi i Greçallisë.

Z. Saimir Kazanxhiu

Doja tu sygjeroja, se ajo me të vërtetë është një rrugë që duhet bërë patjetër, por ju lutem që mqs ajo është në fazën e rregullimit merrni masa që të vendoset edhe një semaforë sepse është burim aksidenti, ose të prishen ato muret, se janë bërë shumë aksidente aty dhe janë vrarë edhe njerëz, me pasoje vdekje. Mqs jemi në këtë fazë, zotërinjtë e bashkisë ta shkruajnë mirë atë projekt, të vendoset një semaforë aty. Plus që është problematikë aty pasi është shkolla jopublike "Dertliu"

Znj. Antoneta Çunaj

Të flasi specialistja në lidhje me pretendimet e ngritura nga ana e këshilltarit.

Znj. Silvana Basha

Nëpërmjet këtij project vendimi është kërkuar zgjerimi I rrugës nga unaza "Skënderbeu" tek kryqëzimi I rrugës "Mujo Ulqinaku". Ndërsa nga unaza "Skënderbeu" deri tek hekurudha, ky segment i rrugës "Kastriot Muço", ose rruga e Çeligradit, mbaroi investimi nga FSHZH-ja. Mori parametra të zgjeruar, sepse në funksion të spitalit Memorial, u bë korsia e emergjencës, dhe pati zgjerim nga të dyja krahët me trotuare. Në përputhje dhe në vazhdim të këtij investimi, bashkia mori masat që në projekt të miratuar në vitin 2022 për segmentin që ne po flasim konkretisht, ta përshtasim me parametrat e rrugës në zhvillim dhe duke ju përshtatur gjithmonë zhvillimit të bizneseve, siç e thashë dhe më përpara, spitalit Memorial. Kështu që kjo rrugë do të bëhet me parametrat 9 m gjerësi dhe dy trotuare nga të dyja krahët

me nga 2 m gjerësi. Ndërkohë që në vitin 2022 nuk kanë qënë këto parametra, dhe pikërisht kërkojmë zgjerimin e kësaj rruge për tu përshtatur me zhvillimin e kohës. Për semaforët nuk të flaës dot sepse jemi konkretisht tek zgjerimi i rrugës. Sinjalistika vertikale dhe horizontale është një detaj më vete për rikonstrukcionin e rrugës, është një grup tjetër që punon për sinjalistikën.

Z.Arben Çuko

Në lidhje me sinjalistikën, është qyteti i vetëm në botë që ka vetëm një semaforë, dhe ai është kot sa për bela aty. Ose I bëni të gjithë semaforët që të komunikojnë dhe të kalojnë njerëzit se është turp. E dyta. Në lidhje me rrugën nga hekurudha e deri tek kthesa e Egnatias, tja dini për faleminderit Gëzimit dhe mua, pasi ne ngulëm këmbë sepse rrugët nuk e di se kush i ndjek dhe kush i hedh firmat për ti marrë ato projekte në dorëzim se rruga erdhi e ngushtuar, fola unë dhe zoti Hajdaraj që rruga u zgjeru se rruga erdhi me ngushtim. Aty u vendosën edhe trotuarët dhe kam ngritur disa herë në mbledhjet e këshillit bashkiak: Ç'farë do të bëhet me heqjen e gabinës elektrike tek rruga nga "Leone" deri tek hekurudha, në krahun e djathtë, është një gabinë elektrike në trotuar, burim aksidenti sepse nuk kanë ku të kalojnë njerëzit. I bani shënim ju apo nuk I mbani shënim? Ku do të kalojnë fëmijët e shkollës aty? Faleminderit

Znj.Silvana Basha

Do të bashkëpunojmë me OSHE-në për zgjidhjen e këtij problem.

Znj.Antoneta Çunaj

E hedhim në votim këtë projekt vendim.Kush është pro?

Pro 31 vota

Kundra 2 vota.

Abstenim 1 votë.

Miratohet

Pika e dytë shtesë e rendit të ditës

Projkt vendim "Per miratimin e financimit të projektit: Mur mbajtes ne rrugen rurale ne fshatin Peshtan Bregas, Njesia Administrative Frakull, Bashkia FIER."

Znj.Antoneta Çunaj

E ka fjalën përfaqësuesja e bashkisë.

Znj.Silvana Basha

Jemi në kushtet e emergjencës, rruga është bërë e pakalueshme, është jashtë parametrave të garancisë për qëndrueshmërinë e strukturs së saj, është një zonë kodrinore e cila e shton më tepër problematikën e qëndrueshmërisë së rrugës. Ka rreth 30 banesa në këtë zonë të cilat përdorin këtë rrugë si akses kalimi. Del e nevojshme ndërhyrja për forcimin e strukturës sepse është në rrezikshmëri fluksi i lëvizjes së mjeteve dhe të këmbësorëve sigurisht edhe banesat që janë në pjesën anësore të kësaj rruge. Projekti është bërë gati, është siguruar edhe fondi i buxhetit, kështu që kërkohet të miratohet hapja e rrugës për procedurat e mëtejshëm të këtij projekti.

Znj.Eleni Gjikonaj

Më falni, të shtoj edhe diçka këtu edhe vlerën e projektit që është në vlerën 12486 667 mijë lekë. Do të hiqet nga zëri, bashkëfinancimi I aparatit dhe do të shtohet zëri për financimin e kësaj rruge. Fondi do të hiqet nga bashkëfinancimet e projektit që e kemi lënë në zërin e bashkisë Fier. Faleminderit!

Znj.Antoneta Çunaj

E hedhim në votim. Kush është pro?

Pro 32 vota

Kundra 2 vota .

Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Pika e tretë shtesë e rendit të ditës

Relacion :” Për dhënien ose jo të pëlqimit në parim për vijimin e procedurave të negocimit për zhvillimin dhe shkëmbimin e pasurive nr. 7/667, 7/498, (7/361) zk 8531, në pronësi të Bashkisë Fier, pasurisë nr. 3/593 zk 8532, pronë shtetërore në administrim të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, sipas projekt propozimit të paraqitur nga DRSHTR Fier”

Znj.Antoneta Çunaj

Këtu jemi thjesht për thënien e pëlqimit paraprak, pasi vendimmarrja do të vijë më mbrapa pasi të hapet rruga për këmbimin e këtre dy pronave shtetërore njëra pronë e Bashkisë Fier dhe tjetra e DRSHTR Fier. Dakort jeni me këtë relacion? Është dikush që dëshiron ta flasi?

Z.Themion Mile

Mqs jam pala e interesuar për këtë pikë, si drejtor I DRSHTR Fier, doja të jepja një shpjegim. DRSHTR Fier mbulon 6 bashki ose jep shërbimin ndaj qytetarëve në lidhje me transportin rrugor, për mjetet. Kemi patur nevoja për zgjerim të hapësirave të drejtorisë sonë ku konsiston në hapësirën për parkim, për largësinë midis drejtorisë ekzistuese dhe qendrës së kontrollit teknik. E gjithë kjo

që duam të krijojmë është krijimi i një kompleksi ku qytetarët të vijnë e të marrin shërbimin në një vend dhe most të lëvizin në distanca të largëta. Është 3.2 km distance nga drejtoria rajonale e deri tek QKT-ja që është në periferi, ku për një shërbim regjistrimi të mjetit për herë të parë, drejtuesit të mjetit të ri do ti duhej ta përshkonte tre herë këtë distancë. Ka një kosto për këtë gjë, ku po themi për 2024 drejtoria rajonale ka regjistruar 8300 mjete. Qytetarët e bashkisë së Patosit, të Roskovecit dhe të Mallakastrës nuk do të hyjnë të marrin shërbim tek drejtoria jonë por do ta marrin atë shërbim atje në periferi. Kjo në bashkëpunim edhe me bashkinë, aty mund të krijohet edhe një qendër ekonomike, duke u krijuar edhe një institucion i ri atje, krijohet edhe një qendër ekonomike ku mund të mos jetë vetëm për shërbimin 8:00- 16:00 por edhe mbas orarit zyrtar. E gjitha kjo është në shërbim të qytetarëve duke hequr kosto financiare për ta. Sipas statistikave rezulton që për katër vite janë bërë diku tek 48 aksidente që do të thotë që është edhe një burim aksidenti atje sepse nuk ka vend parkimi të dedikuar për qytetarët për të marrë një shërbim atje. Të shtoj edhe diçka të fundit. Kur miratohet një program për të bërë një studim fizibiliteti, miratohet në fillim të vitit do të thotë që propozimi që kemi bërë ne në Drejtorinë e Përgjithëshme I përket fundvitit të kaluar dhe miratohet në fillim të vitit, që shkon sipas hierarkisë dhe në fund del VKM-ja.

Znj. Antoneta Çunaj

Është dhënie pëlqimi, nuk është projekt vendim.

Z. Themion Mile

Institucioni jonë do të bëjë studimin atje, do ta paraqesi ekzekutivit, do tja paraqesi për transparencë edhe këshillit bashkiak, pastaj do të vendosim për kalimin ose jo. Pastaj do të shkojë në ministri dhe më pas do të dali VKM-ja dhe do të vihet në zbatim për vitin 2025.

Z. Arben Çuko

Kam për të diskutuar diçka, që e diskutova edhe në mbledhjen e komisionit përkatës. Kemi një problematikë. Aty janë disa prona private, të cilat do të prishen për zbatimin e këtij projekti dhe unë kërkoj që ato të dëmshpërblehen me vlerën e tregut.

Znj. Antoneta Çunaj

Vlera e shpronësimit është me VKM dhe nuk varet nga bashkia. Bashkia nuk ka asnjë tagër të vlerësojë pronat për shpronësim jashtë kriterëve të VKM-së. Kush ka pretendime në lidhje me këtë I zgjidh në rrugë gjyqësore. Nqs një punonjës i bashkisë do të bëjë të kundërtën, ashtu si thoni ju, atëherë ai do të përballlet me akuzën e shpërdorimit të detyrës, pasi merr vendim në kundërshtim me VKM-në.

E hedhim në votim. Kush është pro?

Pro 34 vota

Kundra nuk ka..

Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Pika e katërt shtesë e rendit të ditës

Relacion : “Për vazhdimin e punimeve në fazën e dytë të unazës së Cakranit”.

Znj.Antoneta Çunaj

Për këtë është marrë vendim në janar të vitit 2025, këtu është thjeshtë një relacion informues për vazhdimin e punimeve për fazën e dytë të unazës së Cakranit.Ka diskutime rreth këtij relacioni.

Z.Endri Jaupaj

Është ai projekti i parë që është marrë në dakortësi edhe me banorët?

Znj.Antoneta Çunaj

Po për atë bëhet fjalë.

Z.Endri Jaupaj

Jemi në rregull.

Znj.Antoneta Çunaj

E hedhim në votim.Kush është pro?

Pro 34 vota

Kundra nuk ka..

Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Znj.Antoneta Çunaj

Faleminderit të gjithë këshilltarëve të pranishëm!

Ky proces verbal ka 21 (njëzet e një) faqe, mbahet në tre kopje nga Sekretari i Këshillit Z. Arnando Çupa

Sekretari i Këshillit

Arnando ÇUPA

Kryetar i Këshillit

Antoneta ÇUNAJ